



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr 1285/16 Prot

Tiranë, më 03.12. 2020

VENDIM

Nr. 17, datë 03.12.2020

“PËR

**MENDIM I ARGUMENTUAR MBI MASËN E SHPËRBLIMIT TË DISA ORGANEVE KOLEGJIALE
NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, germa c dhe ç, VKM Nr.329, datë 12.04.2017, “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 18, Statutin e UPT, neni 10, pika 2, germa g, kërkesën e Administratorit të Institucionit me shkresën Nr.1331 Prot, datë 04.11.2020, Senati në mbledhjen e datës 03.12.2020, pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi kërkesën e Administratorit të Universitetit Politeknik të Tiranës, për një mendim të argumentuar lidhur me masën e shpërblimit të disa organeve kolegjinale në Universitetin Politeknik të Tiranës, si Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, Komisionet e Përhershme të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor”, Këshilli i Etikës dhe Komisioneve Zgjedhore,

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.2, datë 28.01.2020, të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, “Mbi masën e shpërblimit të anëtarëve të Komisioneve të Përhershme të Dhënies së gradës shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës”.
2. T’i përcjellë Bordit të Administrimit mendimin e argumentuar lidhur me masën e shpërblimit të disa organeve kolegjinale në Universitetin Politeknik të Tiranës, Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, Komisionet e Përhershme të Dhënies së gradës shkencore “Doktor”, Këshillit të Etikës dhe Komisioneve Zgjedhore, sipas relacionit bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi “Nene Tereza”, Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al